

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Lumni Sallauka, kryetar i kolegjit, Rafet Haxhaj dhe Valon Totaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses KEK SH.A. Distrikti në Mitrovicë, të cilën me autorizim e përfaqëson përfaqësuesja L.V. nga Mitrovica, kundër të paditurës “NN” ..., të cilën e përfaqëson H.Z. nga fshati ..., Komuna e Skenderajit, me objekt të padisë borxh, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Skenderaj C.nr.0458/12, i datës 17.12.2012, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 17.09.2018, mori këtë:

## **A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET** pjesërisht si e bazuar ankesa e të paditurës “NN” ..., Komuna e Skenderajt, **NDRYSHOHET** pjesa e parë e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Skenderaj C.nr.0458/12, i datës 17.12.2012 dhe çështja lëndore gjykohet si në vijim: **DETYROHET** e paditura “NN” ..., Skënderaj, që paditëses KEK SH.A Distrikti në Mitrovicë, për shpenzimet e energjisë elektrike, për periudhën kohore nga data 30.10.2006 e deri me datë 05.12.2012, t’i paguajë borxhin në shumë prej 1,770.90 euro, me kamatë ligjore sipas mjeteve të deponuara pa destinim të caktuar mbi një vit në bankat komerciale të Kosovës, nga data e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë e deri në pagesën definitive.

**II. REFUZHET** pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit KEK SH.A Distrikti në Mitrovicë, nga shuma e aprovuar si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, e deri në shumën e kërkuar prej 4,080.95 euro, **si e pabazuar**.

**III. REFUZHET** si e pabazuar ankesa e të paditurës “NN” ..., Komuna e Skenderajt, ndërsa pjesa e dytë e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Skenderaj C.nr.0458/12, të datës 17.12.2012, e cila ka të bëjë me pagimin e shpenzimeve gjyqësore, **VËRTETOHET**.

## **A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar C.nr.0458/12, i datës 17.12.2012, në pjesën e parë të dispozitivit e ka detyruar të paditurën “NN” ... , të cilën e përfaqëson pronari H.Z., që paditëses KEK SH.A Distrikti në Mitrovicë, për shpenzimet e energjisë elektrike, për periudhën kohore nga data 07.03.2003 gjerë me datë 05.12.2012, t’i paguajë borxhin në shumë prej 4,080.95 euro, me kamatë ligjore prej 3.5% sipas mjeteve të deponuara pa destinim të caktuar mbi një vit në bankat e Kosovës, nga dita e gjykimit 17.12.2012 e deri në pagesën definitive në afat prej 15 diteësh pas plotëfuqishmerisë së këtij aktgjykimi. Ndërsa me pjesën e dytë të dispozitivit është obliguar i padituri që t’i paguajë shpenzimet e taksës gjyqësore në shumë prej 20 euro dhe për hartimin e aktgjykimit shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotëfuqishmerisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura, përmes të autorizuarit të saj në afat ligjor ka paraqitur ankesë duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljes së dispozitive të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të prishet aktgjykimi i atakuar dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe vendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar pala paditëse.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

**-Ankesa e të paditurës është pjesërisht e bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se me datë 30.10.2007, në Gjykatën Komunale në Skenderaj, paditësja në cilësinë e kreditorit ka paraqitur propozim për ekzekutim në bazë të dokumentit autentik (faturave), kundër të paditurit në cilësinë e debitorit, të precizuar në seancën e shqyrtimit kryesor, me të cilin ka kërkuar që të detyrohet debitori që në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, t'i paguaj kreditorit borxhin në shumë prej 4,080.95 euro, në kamat ligjore prej 3.5% nga dita e propozimit në gjykatë, e deri në pagesën definitive të borxhit, së bashku me shpenzimet e këtij ekzekutimi në arkën e kreditorit ose në llogarinë bankare në Raiffeisen Bank, nr.000000000000, në të kundërtën gjykata do të bejë përmbushjen e ekzekutimit me dhunë, ashtu që sendet e luajtshme të debitorit të regjistrohen, vlerësohen, të sekuestrohen dhe të shiten, të cilat ndodhen në posedim të tij deri në vlerën e borxhit, e nëse debitori ushtron kundërshtim ndaj këtij aktvendimi, i njëjti do të konsiderohet padi, kurse në rast se pagesa e borxhit së bashku me shpenzimet është bërë në afatin prej 8 ditësh, propozimi për ekzekutim do të tërhiqet.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas propozimit për përmbarim të kreditorit me aktvendimin Ekz.nr.546/07 të datës 08.11.2007, e ka lejuar përmbarimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur prapsim me të cilin kundërshton vlerën e faturave pasi që mendon që nuk i përgjigjen shpenzimeve të bëra të energjisë elektrike, si dhe ka arritur parshkrimi i kërkesës për pjesën më të madhe të borxhit, me propozim që të aprovohet kundërshtimi i debitorit dhe lënda të kthehet në procedurën kontestimore, apo që kreditori në të njëjtën procedurë të hjekë dorë nga shpenzimet e pa bëra e njëkohësisht t'i mbulojë shpenzimet e debitorit.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.0458/12, të datës 17.12.2012, me të cilin e ka aprovuar kërkespadinë e paditëses si të bazuar, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nga leximi i faturës me shifrën DMI-9023433 të datës 23.09.2007 dhe listën e transaksionit të konsumatorëve (ekstrakti në librat afariste) DMI-9023433 e datës 17.12.2012, në mënyrë të padyshimt vërtetohet fakti se i padituri për shfrytëzimin e energjisë elektrike, i ka borxh paditëses shumë në lartësi prej 4.0801.95 euro, për qka edhe kjo gjykatë ka ardhur në përfundim dhe ka vërtetuar se ekziston detyrimi juridiko civil i të paditurit ndaj paditëses, për borxhin në

shumën e cekur si më lartë. Ndërsa pretendimin e debitorit se borxhi është parashkruar, gjykata e shkallës së parë duke ju referuar nenit 387 paragrafi 1 i LMD-së, e ka konsideruar si të pabazuar. Për bazën juridike të kërkesëpadsisë gjykata e shkallës së parë ju ka referuar nenit 387 pika 1 dhe 2, neni 392 pika 1 dhe 2 të LMD-së dhe nenit 143 të LPK-së, ndërsa vendimit për shpenzime të procedurës gjykata ju ka referuar nenit 449 paragrafi 1 dhe 452 paragrafi 1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, ndërsa gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë, përveç se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar dhe atë dispozitat e LMD-së që kanë të bëjnë me parashkrimin e kërkesës së paditësit, për çka edhe janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 201 pika d) e LPK-së, për të ndryshuar pjesërisht aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sikurse në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Duke e shqyrtuar aktgjykimin në kufijtë e pretendimeve ankimore, Gjykatës së Apelit i ka rezultuar si i bazuar pretendimi ankimor i palës së paditur i cekur në ankesë se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është nxjerrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Kjo për faktin se me rastin e caktimit të shumës së borxhit në emër të shpenzimeve të energjise elektrike, gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë për bazë, faktin se një pjesë e borxhit të të paditurit është parashkruar. Kjo për faktin se deri me datë 20.12.2012 borxhi i përgjithshëm i të paditurit ka qenë 4,080.95 euro, ndërsa paditësja propozimin për ekzekutim e ka ushtruar me datë 30.10.2007, ndërsa i padituri deri me këtë datë nuk ka bërë asnjë pagesë, ndërsa nga kjo rrjedhë se shuma e borxhit të paditurit nga data 07.03.2003 e deri me datë 30.10.2006 (duke llogaritur 1 (një) vit mbrapa datës së parashtrimit të propozimit për përmbarrim në gjykatë nga paditësi), apo shuma e kërkuar prej 2,310.05 euro është parashkruar konform nenit 378 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, i cili shprehimisht thotë: *“Parashkruhen për një vit: Kërkesa e kompensimit për lëvrimin e energjisë elektrike e të ngrohjes, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e pastërtisë kur lëvrimi, respektivisht shërbimi është kryer për nevoja shtëpiake”*. Në rastin konkret, ndërprerja e afatit të parashkrimit të kërkesës së paditësit është bërë me rastin e parashtrimit të propozimit për përmbarrim në gjykatë, apo data 30.10.2007, e tutje, për çka si obligim i palës së paditur për pagesën e borxhit paditëses në emër të shpenzimeve për shfrytëzimin e energjisë elektrike, ka mbetur shuma e cekur në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, apo shuma prej 1,770.90 euro dhe atë për periudhën prej datës 30.10.2006 e deri me datë 05.12.2012.

Në anën tjetër, përveç të cekurave më lartë e që kanë të bëjnë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale nga gjykata e shkallës së parë, në lidhje me parashkrimin e pjesërishtëm të kërkesës së paditësit, nuk qëndrojnë pretendimet tjera ankimore të palës së paditur për shkeljet që i referohen konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, pasi që arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje me dispozitën e nenit 160 paragrafi 4 dhe 5 i LPK-së, meqë gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet e çështjes, për provat të cilat i ka shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve dhe për vlerësimin e tyre. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshe vendimtare për themelësinë e kërkesëpadsisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Si rrjedhë, për shkak të mangësive të evidentuara më lartë, e që i referohen zbatimit të gabuar të së drejtës materiale në lidhje me parashkrimin e pjesërishëm të kërkesës së paditësit, gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar se janë krijuar kushtet ligjore që të mund të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, sikurse në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të cekurat me lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, dhe 195 parag.1 pika (e), lidhur me nenin 201 pika d) e LPK-së, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.243/2014, datë 17.09.2018**

**Kryetari i kolegjit**  
**Lumni Sallauka, d.v**